Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 8
Segmentet e Shfrytëzimit

Parimi themelor

1 **Një njësi ekonomike do të japë informacione shpjeguese për t`iu dhënë mundësi përdoruesve të pasqyrave financiare të saj të vlerësojnë natyrën dhe efektet financiare të veprimtarive të biznesit, në të cilat ajo angazhohet dhe mjediset ekonomike në të cilat kryen veprimtarinë.**

Objekti

2 Ky SNRF do të zbatohet për:

(a) pasqyrat financiare individuale të një njësie ekonomike:

(i) instrumentet e borxhit ose të kapitalit neto të së cilës tregtohen në një treg publik (bursë vendase ose e huaj ose në një treg jashtë bursave, përfshirë tregjet vendore dhe rajonale), ose

(ii) e cila depoziton ose është në proces të depozitimi të pasqyrave financiare të saj pranë një komisioni të letrave me vlerë ose një organizmi tjetër rregullator me qëllim emetimin e ndonjë kategorie të instrumenteve në një treg publik; dhe

(b) pasqyrat financiare të konsoliduara të një grupi me një shoqëri mëmë:

(i) instrumentet e borxhit ose të kapitalit neto të së cilës tregtohen në një treg publik (bursë vendase ose e huaj ose në një treg jashtë bursave, përfshirë tregjet vendore dhe rajonale), ose

(ii) e cila depoziton ose është në proces depozitimi të pasqyrave financiare të konsoliduara pranë një komisioni të letrave me vlerë ose organizmi tjetër rregullator me qëllim emetimin e ndonjë kategorie të instrumenteve në një treg publik.

3 Në qoftë se një njësi ekonomike, të cilës nuk i kërkohet të zbatojë këtë SNRF, vendos të japë informacion shpjegues për segmentet, të cilat nuk janë në pajtim me këtë SNRF, ajo nuk duhet ta përshkruajë informacion si informacion të segmentit.

4 Në qoftë se një raport financiar përmban si pasqyrat financiare të konsoliduara të një shoqërie mëmë e cila është brenda objektit të këtij SNRF-je, ashtu edhe pasqyrat financiare individuale, informacioni për segmentet kërkohet vetëm për pasqyrat financiare të konsoliduara.

Segmentet e shfrytëzimit

5 Segmenti i shfrytëzimit është një pjesë përbërëse e një njësie ekonomike:

(a) që angazhohet në veprimtari biznesi nga e cila ai mund të fitojë të ardhura dhe të bëjë shpenzime (përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet të cilat kanë lidhje me transaksionet e kryera me përbërës të tjerë të së njëjtës njësi ekonomike),

(b) rezultatet e shfrytëzimit të të cilit janë shqyrtuar rregullisht nga shefi i marrjes së vendimeve në nivel operativ i njësisë ekonomike për qëllime të marrjes së vendime në lidhje me burimet që do t'i shpërndahen segmentit dhe për të vlerësuar performancën e tij, dhe

(c) për të cilin ka informacion financiar të veçantë.

Një segment shfrytëzimi mund të angazhohet në veprimtari biznesi për të cilat ai ende nuk ka përfituar të ardhura, për shembull, veprimtaritë e nisjes e të zgjerimit mund të jenë segmente të shfrytëzimit përpara se të fitohen të ardhura.

6 Jo çdo pjesë e një njësie ekonomike është domosdoshmërisht një segment shfrytëzimi apo pjesë e një segmenti shfrytëzimi. Për shembull, selia qendrore e një shoqërie anonime ose disa departamente funksionale mund të mos fitojnë të ardhura ose mund të fitojnë të ardhura të cilat janë anësore për aktivitetet e njësisë ekonomike dhe nuk do të ishin segmente shfrytëzimi. Për qëllimet e kësaj SNRF-je, skemat e përfitimeve të pas-punësimit të një njësie ekonomike nuk janë segmente të shfrytëzimit.

7 Termi ‘shefi i marrjes së vendimeve në nivel operativ’ identifikon një funksion, dhe jo domosdoshmërisht një drejtues me një titull të caktuar. Funksioni i tij është të shpërndajë burimet dhe të vlerësojë performancën e segmenteve të shfrytëzimit të një njësie ekonomike. Shpesh, shefi i marrjes së vendimeve në nivel operativ i një njësie ekonomike është drejtori ekzekutiv ose përgjegjësi i veprimtarive të shfrytëzimit, por ai mund jetë, për shembull, një grup drejtorësh ekzekutivë ose të tjerë.

8 Për shumë njësi ekonomike, tri karakteristikat e segmenteve të shfrytëzimit,të përshkruara në paragrafin 5, identifikojnë qartë segmentet e shfrytëzimit të tyre. Megjithatë, një njësi ekonomike mund të nxjerrë raporte në të cilat veprimtaritë e saj të biznesit janë paraqitur në një shumëllojshmëri mënyrash. Në qoftë se shefi i marrjes së vendimeve në nivel operativ përdor më shumë se një paketë informacionesh të segmentit, ka faktorë të tjerë, të cilët mund të identifikojnë një paketë të vetme të përbërësve si segment shfrytëzimi të njësisë ekonomike, përfshirë natyrën e veprimtarive të biznesit të çdo përbërësi, ekzistencën e drejtuesve përgjegjës për to dhe informacionin që i paraqitet bordit të drejtorëve.

9 Në përgjithësi, një segment shfrytëzimi ka një drejtues segmenti, i cili jep llogari drejtpërdrejt tek dhe mban kontakte të rregullta me shefin e marrjes së vendimeve në nivel operativ për të diskutuar për veprimtaritë e shfrytëzimit, rezultatet financiare, parashikimet ose planet për segmentin. Termi ‘drejtues segmenti’ identifikon një funksion, dhe jo medoemos një drejtues me një titull të caktuar. Shefi i marrjes së vendimeve në nivel operativ mund të jetë gjithashtu, drejtues segmenti për disa segmente shfrytëzimi. Një drejtues i vetëm mund të jetë drejtues segmenti për më shumë se një segment shfrytëzimi. Në qofte se karakteristikat që jepen në paragrafin 5 zbatohen për më shumë se një grup përbërësish të një organizate, por ka vetëm një grup për të cilat mbajnë përgjegjësi drejtuesit e segmenteve, ky grup përbërësish përbën segmentet e shfrytëzimit.

10 Karakteristikat e paragrafit 5 mund të zbatohen për dy ose më shumë grupe të mbi vendosura përbërësish për të cilat mbajnë përgjegjësi drejtuesit. Kjo strukturë, shpeshherë referohet si forma matricë e organizimit. Për shembull, në disa njësi ekonomike, disa drejtues janë përgjegjës për linja të ndryshme të produktit dhe shërbimit në gjithë botën, ndërkohë drejtues të tjerë janë përgjegjës për zonat gjeografike të caktuara. Shefi i marrjes së vendimeve në nivel operativ shqyrton rregullisht rezultatet e shfrytëzimit për të dy grupet e përbërësve, dhe informacioni financiar është i disponueshëm për të dyja grupet. Në një situatë të tillë, njësia ekonomike përcakton se cili grup i përbërësve përbën segment shfrytëzimi sipas parimit themelor.

Segmentet raportuese

11 Një njësi ekonomike e raporton veças informacionin për çdo segment shfrytëzimi që:

(a) ka qenë identifikuar sipas paragrafëve 5-10 ose që rezulton nga bashkimi i dy ose më shumë prej këtyre segmenteve në përputhje me paragrafin 12, dhe

(b) kalon kufijtë sasiorë që janë dhënë në paragrafin 13.

Paragrafët 14-19 specifikojnë situatat e tjera në të cilat, për një segment shfrytëzimi do të raportohet informacion i veçantë.

Kriteret e bashkimit

12 Segmentet e shfrytëzimit shpesh shfaqin performancë financiare afatgjatë të ngjashme në qoftë se ata kanë karakteristika ekonomike të ngjashme. Për shembull, për dy segmente shfrytëzimi do të priten marzhe bruto mesatare afatgjata të ngjashme në qoftë se karakteristikat ekonomike të tyre kanë qenë të ngjashme. Dy ose më shumë segmente shfrytëzimi mund të bashkohen në një segment shfrytëzimi të vetëm po qe se bashkimi është në koherencë me parimin kryesor të këtij SNRF-je, po qe se segmentet kanë karakteristika ekonomike të ngjashme dhe segmentet janë të ngjashme në secilin prej aspekteve të mëposhtme:

(a) natyrën e produkteve dhe shërbimeve;

(b) natyrën e proceseve të prodhimit;

(c) llojin ose kategorinë e klientit për produktet dhe shërbimet e tyre;

(d) metodat e përdorura për shpërndarjen e produkteve ose dhënien e shërbimeve të tyre; dhe

(e) në qoftë se ka kuptim, natyrën e mjedisit rregullator, për shembull për shërbimin bankar, sigurimet ose shërbimet komunale publike.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Kufijtë sasiorë

13 Një njësi ekonomike raporton veças informacionin për një segment të shfrytëzimit që përmbush çdonjërin prej kufijve sasior të mëposhtëm:

(a) Të ardhurat e raportuara të tij, përfshirë si shitjet për klientët e jashtëm ashtu edhe shitjet midis segmenteve ose transferimet, janë sa 10 përqind ose më shumë e të ardhurave të kombinuara, të brendshme dhe të jashtme, të të gjitha segmenteve të shfrytëzimit.

(b) Shuma absolute e fitimit ose e humbjes së raportuar prej tij është sa 10 përqind ose më tepër e shumës më të madhe, në shifër absolute midis, (i) fitimit të kombinuar të raportuar për të gjitha segmentet e shfrytëzimit të cilat nuk kanë raportuar humbje dhe (ii) humbjes të kombinuar të raportuar nga të gjitha segmentet e shfrytëzimit që kanë raportuar një humbje.

(c) Aktivet e tij janë në masën 10 përqind ose më shumë, e aktiveve gjithsej të të gjitha segmenteve të shfrytëzimit.

Segmentet e shfrytëzimit që nuk plotësojnë ndonjë nga kufijtë sasiorë mund të konsiderohen si raportues, dhe për to të jepen informacione veças, po qe se drejtimi beson se informacioni për segmentin do të ishte i dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare.

14 Një njësi ekonomike mund të kombinojë informacionin për segmentet e shfrytëzimit që nuk plotësojnë kufijtë sasiorë, me informacionin për segmentet e tjera të shfrytëzimit që nuk plotësojnë kufijtë sasiorë për të nxjerrë një segment raportues, vetëm në qoftë se segmentet e shfrytëzimit kanë karakteristika ekonomike të ngjashme dhe kanë të përbashkët një pjesë të madhe të kritereve të bashkimit të renditura në paragrafin 12.

15 Në qoftë se të ardhurat gjithsej të jashtme të raportuara nga segmentet e shfrytëzimit përbëjnë më pak se 75 përqind e të ardhurave të njësisë ekonomike, mund të identifikohen si segmente raportuese edhe segmente të tjera të shfrytëzimit (madje edhe në qoftë se ato nuk plotësojnë kriteret e dhënë në paragrafin 13) derisa të paktën 75 përqind e të ardhurave të njësisë ekonomike të përfshihet në segmentet raportues.

16 Informacioni për veprimtaritë e tjera të biznesit dhe segmentet e shfrytëzimit,të cilët nuk janë raportues, do të bashkohet dhe deklarohet në një kategori të quajtur ‘segmente të tjera’ veças zërave të tjerë që rakordohen në rakordimet e kërkuara nga paragrafi 28. Për burimet e të ardhurave të përfshira në kategorinë e quajtur 'segmente të tjera’ do të jepen informacione shpjeguese.

17 Në qoftë se drejtimi gjykon se një segment shfrytëzimi i identifikuar si segment raportues në periudhën paraardhëse, ka kuptim të vazhdojë të identifikohet kështu edhe në vijim, informacioni për këtë segment në periudhën aktuale do të vijojë të raportohet veças, madje edhe në qoftë se ai nuk plotëson më kriteret për raportueshmërinë, të dhënë në paragrafin 13.

18 Në qoftë se një segment shfrytëzimi është identifikuar si segment raportues në periudhën aktuale në përputhje me kufijtë sasiorë, të dhënat e segmentit për një periudhë paraardhëse të paraqitur për qëllime krahasuese do të ri paraqiten për të reflektuar segmentin e ri raportues si një segment të veçantë, madje edhe në qoftë se ky segment nuk plotësonte kriteret për raportueshmërinë të dhënë në paragrafin 13, në periudhën e mëparshme, me përjashtim të rasteve kur mungon informacioni i nevojshëm dhe kostoja për të përgatitur këtë informacion do të ishte tepër e lartë.

19 Mund të ketë një kufi praktik për numrin e segmenteve raportuese për të cilat një njësi ekonomike jep informacion më vete, përtej të cilit informacioni për segmentin mund të bëhet i hollësishëm më tepër nga ç'duhet. Megjithëse nuk është përcaktuar ndonjë kufi i prerë, me rritjen e numrit të segmenteve që janë raportuese sipas paragrafëve13-18 mbi shifrën dhjetë, njësia ekonomike duhet të shikojë nëse është arritur ky kufi praktik apo jo.

Dhënia e informacioneve shpjeguese

20 Një njësi ekonomike do të japë informacione shpjeguese për t`iu dhënë mundësi përdoruesve të pasqyrave financiare të saj të vlerësojnë natyrën dhe efektet financiare të veprimtarive të biznesit, në të cilat ajo angazhohet dhe mjediset ekonomike në të cilat kryen veprimtarinë.

21 Që të ketë efekt parimi i paragrafit 20, një njësi ekonomike, për çdo periudhë për të cilën paraqitet një pasqyrë e të ardhurave gjithëpërfshirëse, duhet të japë informacionet shpjeguese të mëposhtme:

(a) informacion të përgjithshëm siç përshkruhet në paragrafin 22;

(b) informacion për fitimin ose humbjen e segmentit të raportuar, përfshirë të ardhura dhe shpenzimet e specifikuara, të përfshira në fitimin ose humbjen e segmentit të raportuar, aktivet e

segmentit, detyrimet e segmentit dhe bazën e matjes, sikurse përshkruhet në paragrafët 23-27; dhe

(c) rakordimet e shumave gjithsej të të ardhurave të segmentit, fitimit ose humbjes të segmentit të raportuar, aktivet e segmentit, detyrimet e segmentit dhe zërat e tjerë materialë të segmenteve me shumat përkatëse të njësisë ekonomike sikurse përshkruhet në paragrafin 28.

Rakordimet e shumave ne pasqyrën e pozicionit financiar për segmentet raportuese me shumat e pasqyrës të pozicionit financiar të njësisë ekonomike kërkohet të bëhet për çdo datë në të cilën paraqitet një pasqyrë e pozicionit financiar. Informacioni për periudhat e mëparshme duhet të riparaqitet sikurse përshkruhet në paragrafët 29 dhe 30.

Informacion i përgjithshëm

22 Një njësi ekonomike do të japë informacionin e përgjithshëm të mëposhtëm:

(a) faktorët e përdorur për identifikimin e segmenteve raportues të njësisë ekonomike, përfshirë bazën e organizimit (për shembull, nëse drejtimi ka zgjedhur të organizojë njësinë ekonomike sipas produkteve dhe shërbimeve të ndryshme, zonave gjeografike, kushteve rregullatore, ose sipas një kombinimi të faktorëve të ndryshëm, dhe nëse segmentet janë bashkuar):

(aa) gjykimet e bëra nga drejtimi në aplikimin e kritereve të bashkimit në paragrafin 12. Kjo përfshin një përshkrim të shkurtër të segmenteve të shfrytëzimit që janë bashkuar në këtë mënyrë dhe indikatorët ekonomik që janë vlerësuar në vendimin e marrë që bashkimi i segmenteve të shfrytëzimit ndajnë karakteristika të njëjta ekonomike; dhe

(b) llojet e produkteve e shërbimeve nga të cilët çdo segment raportues krijon të ardhurat e tij.

Informacioni rreth fitimit ose humbjes, aktiveve dhe detyrimeve

23 Njësia ekonomike do të raportojë një matës fitimi ose humbjeje për çdo segment të raportueshëm Njësia ekonomike do të raportojë një matës të aktiveve dhe detyrimeve totale për secilin segment të raportueshëm nëse këto shuma i jepen në mënyrë të rregullt vendimmarrësve kryesorë të shfrytëzimit. Gjithashtu, njësia ekonomike do të japë informacionin shpjegues në vijim për secilin prej segmenteve të raportueshëm nëse shumat e specifikuara janë përfshirë në matësin e fitimit ose humbjes të segmentit të rishikuar nga vendimmarrësi kryesor i shfrytëzimit, ose janë raportuar rregullisht tek vendimmarrësi kryesor i shfrytëzimit edhe pse nuk janë të përfshira në atë matës të fitimit ose të humbjes të segmentit:

(a) të ardhura nga klientët e jashtëm;

(b) të ardhurat nga transaksionet me segmente të tjera të shfrytëzimit të së njëjtës njësi ekonomike;

(c) të ardhurat nga interesi;

(d) shpenzime interesi;

(e) zhvlerësimi dhe amortizimi;

(f) zërat materiale të të ardhurave dhe shpenzimeve të paraqitura në përputhje me paragrafin 42 të SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare*;

(g) interesi i njësisë ekonomike në fitimin ose humbjen e pjesëmarrjeve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta të llogaritur sipas metodës së kapitalit neto;

(h) shpenzimin ose të ardhurën nga tatimi mbi të ardhurat; dhe

(i) zërat materiale jo monetare, përveç zhvlerësimit dhe amortizimit.

Një njësi ekonomike do të raportojë të ardhurat nga interesi veças nga shpenzimet për interesin për çdo segment raportues me përjashtim të rasteve kur një pjesë e madhe e të ardhurave të segmentit vijnë nga interesi dhe shefi i marrjes së vendimeve të shfrytëzimit, për të vlerësuar performancën e segmentit dhe për të marrë vendime në lidhje me burimet që do t'i shpërndahen segmentit, mbështetet kryesisht në të ardhurat neto të interesit. Në këto kushte, një njësi ekonomike mund ta raportojë këtë të ardhur nga interesi të segmentit në trajtë neto, pasi t'i ketë zbritur shpenzimet për interesin, dhe të japë informacione shpjeguese se ai ka vepruar në këtë mënyrë.

24 Një njësi ekonomike do të japë informacionet shpjeguese të mëposhtme për çdo segment raportues, nëse shumat e specifikuara janë përfshirë në matjen e aktiveve të segmentit dhe janë rishikuar nga shefi i marrjes së vendimeve në nivel operativ, ose i janë dhënë rregullisht shefit të marrjes së vendimeve në nivel operativ, madje edhe nëse nuk janë përfshirë në matjen e aktiveve të segmentit:

 © Fondacioni i SNRF-ve

(a) shuma e investimit në pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta të llogaritura sipas metodës së kapitalit neto, dhe

(b) shumat e shtesave për aktivet afatgjata[1] përveç instrumenteve financiare, aktiveve për tatim të shtyrë, aktiveve neto të përfitimeve të përcaktuara (shih SNK 19 *Përfitimet e punonjësve*) dhe të drejtat që rrjedhin nga kontratat e sigurimit.

Matja

25 Shuma e çdo zëri të segmentit të raportuar do të jetë matja që i raportohet shefit të marrjes së vendimeve në nivel operativ për qëllime të shpërndarjes së burimeve për segmentin dhe vlerësimin e performancës së tij. Rregullimet dhe eliminimet e bëra gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të një njësie ekonomike dhe shpërndarjet e të ardhurave, shpenzimeve dhe fitimeve ose humbjeve neto do të përfshihen në përcaktimin e fitimit ose të humbjes së segmentit vetëm në qoftë se ato janë përfshirë në matjen e fitimit ose të humbjes së segmentit që është përdorur nga shefi i marrjes së vendimeve në nivel operativ. Në mënyrë të ngjashme, vetëm ato aktive dhe detyrime të cilat përfshihen në matjen e aktiveve dhe detyrimeve të segmentit, të cilat përdoren nga shefi i marrjes së vendimeve në nivel operativ, do të raportohen për këtë segment. Në qoftë se shumat shpërndahen për fitimin ose humbjen, aktivet ose detyrimet e segmentit raportues, këto shuma do të shpërndahen mbi një bazë të arsyeshme.

26 Në qoftë se shefi i marrjes së vendimeve të shfrytëzimit përdor vetëm një matje të fitimit ose të humbjes të një segmenti shfrytëzimi,aktivet dhe detyrimet e segmentit për të vlerësuar performancën dhe për të vendosur për mënyrën se si të shpërndajë burimet, fitimi ose humbja e segmentit dhe aktivet e detyrimet e tij do të raportohen me këto matje. Në qoftë se shefi i marrjes së vendimeve në nivel operativ përdor më shumë se një matje të fitimit ose të humbjes të një segmenti të shfrytëzimit, të aktiveve ose detyrimeve të segmentit, matjet e raportuara do të jenë ato, të cilat drejtimi beson se janë përcaktuar në përputhje me parimet e matjes që janë më shumë në koherencë me ato që janë përdorur në matjet e shumave korresponduese në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike.

27 Një njësi ekonomike do të japë një shpjegim të matjeve të fitimit ose humbjes së segmentit, aktiveve dhe detyrimeve të segmentit raportues. Një njësi ekonomike do të japë informacione shpjeguese, të paktën për:

(a) bazën kontabël për çdo transaksion midis segmenteve raportuese.

(b) natyrën e diferencave midis matjeve të fitimeve ose humbjeve të segmenteve raportuese dhe fitimit ose humbjes së njësisë ekonomike përpara shpenzimit të tatimit mbi të ardhurat ose të ardhurat dhe operacionet jo të vijueshme (në qoftë se nuk evidentohen nga rakordimet e përshkuara në paragrafin 28). Këto diferenca mund të përfshijnë politikat kontabël dhe politikat për shpërndarjen e kostove të kryera në mënyrë të centralizuar, të cilat janë të nevojshme për të kuptuar informacionin e segmentit të raportuar.

(c) natyrën e ndonjë diference midis matjeve të aktiveve të segmenteve raportuese dhe aktiveve të njësisë ekonomike (në qoftë se nuk evidentohen nga rakordimet e përshkuara në paragrafin 28). Këto diferenca mund të përfshihen politikat kontabël dhe politikat për shpërndarjen e aktiveve të përdorura bashkërisht të cilat janë të nevojshme për të kuptuar informacionin e segmentit të raportuar.

(d) natyrën e ndonjë diference midis matjeve të detyrimeve të segmenteve raportuese dhe detyrimeve të njësisë ekonomike (në qoftë se nuk evidentohen nga rakordimet e përshkuara në paragrafin 28). Këto diferenca mund të përfshijnë politikat kontabël dhe politikat për shpërndarjen e detyrimeve të përdorura bashkërisht, të cilat janë të nevojshme për të kuptuar informacionin e segmentit të raportuar.

(e) natyrën dhe efektin e ndonjë ndryshimi nga periudhat e mëparshme në metodat e matjes të përdorura për të përcaktuar fitimin ose humbjen e segmentit të raportuar dhe efektin, nëse ka, të këtyre ndryshimeve në matjen e fitimit ose të humbjes së segmentit.

(f) natyrën dhe efektin e ndonjë shpërndarje asimetrike për segmentet raportuese. Për shembull, një njësi ekonomike mund të shpërndajë shpenzimet e amortizimit te një segment pa i shpërndarë këtij segmenti aktivet përkatëse të amortizueshme.

Rakordimet

28 Një njësi ekonomike do të bëjë rakordimet e të gjithë zërave të mëposhtëm:

[1] Për aktivet e klasifikuara sipas paraqitjes së likuiditetit, aktivet afatgjata janë aktive të cilat përfshijnë vlerat e pritura të rikuperohen për më shumë se 12 muaj pas periudhës së raportimit financiar.

(a) shumën gjithsej të të ardhurave të segmenteve raportuese me të ardhurat e njësisë ekonomike.

(b) shumën gjithsej të matjeve të fitimit ose humbjes të segmenteve raportuese me fitimin ose humbjen e njësisë ekonomike përpara shpenzimit tatimor (të ardhurës tatimore) dhe të veprimtarive jo të vijueshme. Megjithatë, në qoftë se njësia ekonomike i'u shpërndan segmenteve raportuese zëra të tillë si shpenzime (të ardhura) tatimore, njësia ekonomike mund ta rakordojë totalin e matjeve të fitimit ose të humbjes të segmenteve me humbjen ose fitimin e njësisë ekonomike pas këtyre zërave.

(c) totali i aktiveve të segmenteve raportuese në aktivet e njësisë ekonomike në qoftë se aktivet e segmentit janë raportuar në përputhje me paragrafin 23.

(d) shumën gjithsej të detyrimeve të segmenteve raportuese me detyrimet e njësisë ekonomike në qoftë se detyrimet e segmenteve janë raportuar në përputhje me paragrafin 23.

(e) totalin e shumave të segmenteve raportuese për çdo zë tjetër material, të informacionit shpjegues të dhënë për shumën përkatëse të njësisë ekonomike.

Të gjithë zërat materiale që rakordohen do të jenë identifikuar e përshkruar veças. Për shembull, shuma e çdo rregullimi material që nevojitet për të rakorduar fitimin ose humbjen e segmenteve raportues me fitimin ose humbjen e njësisë ekonomike që rrjedh nga politikat e ndryshme kontabël, do të identifikohet dhe përshkruhet veças.

Riparaqitja e informacionit të raportuar më parë

29 Në qoftë se një njësi ekonomike ndryshon strukturën e organizimit të saj të brendshëm në një mënyrë të atillë e cila shkakton ndryshimin e përbërjes së segmenteve të saj raportuese, informacioni që i korrespondon periudhave të mëparshme, përfshirë periudhat e ndërmjetme, do të ri paraqitet, përveç rasteve kur informacioni nuk është disponibël dhe kostoja e përgatitjes së tij do të ishte tepër e lartë. Përcaktimi nëse informacioni është ose jo i disponueshëm dhe nëse kostoja e përgatitjes së tij do të ishte tepër e lartë do të bëhet për çdo zë të veçantë të informacioneve shpjeguese të dhëna. Në vijim të një ndryshimi në përbërjen e segmenteve të saj raportuese, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për faktin nëse ajo i ka ri paraqitur ose jo zërat korresponduese të informacionit të segmenteve për periudhat e mëparshme.

30 Në qoftë se njësia ekonomike ka ndryshuar strukturën e organizimit të brendshëm në një mënyrë të atillë që shkakton ndryshimin e përbërjes së segmenteve të saj raportuese dhe në qoftë se informacioni i segmentit për periudhat e mëparshme, përfshirë edhe periudhat e ndërmjetme, nuk është ri paraqitur për të reflektuar ndryshimin, njësia ekonomike do të japë informacionin shpjegues të segmentit në vitin në të cilin ndodh ndryshimi, për periudhën aktuale të deklaruar si mbi bazën e vjetër ashtu edhe mbi bazën e re të segmentimit, përveç rasteve kur informacioni nuk është i disponueshëm dhe kosto e përgatitjes së tij do të ishte tepër e lartë.

Dhënia e informacioneve shpjeguese për të gjithë njësinë ekonomike

31 Paragrafët 32–34 zbatohen për të gjitha njësitë ekonomike të cilat i nënshtrohen këtij SNRF-je, përfshirë ato njësi ekonomike të cilat kanë vetëm një segment raportues. Disa veprimtari biznesi të njësive ekonomike nuk organizohen në bazë të dallimeve midis produkteve dhe shërbimeve ose dallimeve sipas zonave gjeografike të veprimtarive. Segmentet raportuese të këtyre njësive ekonomike mund të raportojnë të ardhura nga një gamë e gjerë produktesh dhe shërbimesh të ndryshme, ose më shumë sesa një prej segmenteve të saj raportuese mund të japin kryesisht të njëjtat produkte dhe shërbime. Po kështu, segmentet raportuese të një njësie ekonomike mund të mbajnë aktive në zona të ndryshme gjeografike dhe të raportojnë të ardhura nga klientët në zona të ndryshme gjeografike, ose më shumë se një prej segmenteve të tyre raportuese mund të kryejë veprimtarinë në të njëjtën zonë gjeografike. Informacioni i kërkuar nga paragrafët 32–34 do të jepet vetëm në qoftë se nuk është dhënë si pjesë e informacionit të segmentit raportues të kërkuar nga ky SNRF.

Informacion për produktet dhe shërbimet

32 Njësia ekonomike do të raportojë të ardhurat nga klientët e jashtëm për çdo produkt dhe shërbim, ose për çdo grup produktesh dhe shërbimesh të ngjashme, përveç rasteve kur informacioni nuk është i disponueshëm dhe kosto e përgatitjes së tij do të ishte tepër e lartë, fakt për të cilin duhet të jepen informacione shpjeguese. Shumat e të ardhurave të raportuara do të bazohen në informacionin financiar të përdorur për përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë ekonomike.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Informacion për zonat gjeografike

33 Një njësi ekonomike do të raportojë informacionin gjeografik të mëposhtëm, përveç rasteve kur informacioni nuk është i disponueshëm dhe kosto e përgatitjes së tij do të ishte tepër e lartë:

(a) të ardhurat nga klientët e jashtëm (i) që i përkasin vendit të rezidencës të njësisë ekonomike dhe (ii) që i përkasin të gjitha vendeve të huaja në total, nga të cilat njësia ekonomike krijon ardhurat. Në qoftë se të ardhurat nga klientët e jashtëm, që i përkasin një vendi të huaj të veçantë, janë materiale, për këto të ardhura do të jepen informacione shpjeguese të veçanta. Njësia ekonomike do të japë informacion për bazën e ndarjes së të ardhurave nga klientët e jashtëm për çdo vend të veçantë.

(b) aktivet afatgjata[2] përveç instrumenteve financiare, aktiveve për tatimin e shtyrë, aktiveve për përfitimet e pas-punësimit dhe të drejtat që rrjedhin nga kontratat e sigurimit (i) që ndodhen në vendin e rezidencës të njësisë ekonomike dhe (ii) ndodhen në të gjitha vendet e huaja në total, në të cilat njësia ekonomike mban aktivet. Në qoftë se aktivet në një vend të huaj të veçantë janë materiale, për këto aktive do të jepen informacione shpjeguese të veçanta.

Shumat e raportuara do të bazohen në informacionin financiar të përdorur për përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë ekonomike. Në qoftë se informacioni i nevojshëm nuk është disponibël dhe kosto e përgatitjes së tij do të ishte tepër e lartë, për këtë fakt duhet të jepen informacione shpjeguese. Përveç informacionit të kërkuar nga paragrafi i mësipërm, një njësi ekonomike duhet të japë informacion edhe për totalin sipas zonave gjeografike dhe grup vendeve të ndryshme.

Informacioni për klientët kryesorë

34 Një njësi ekonomike do të japë informacion për shkallën me të cilën ajo mbështetet në klientët kryesorë. Në qoftë se të ardhurat nga transaksionet me një klient të jashtëm të vetëm janë sa 10 përqind ose më shumë e të ardhurave të njësisë ekonomike, njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt, për shumën gjithsej të të ardhurave nga çdo klient i tillë, dhe identitetin e segmentit apo të segmenteve që raportojnë të ardhurat. Njësia ekonomike nuk duhet të japë informacion për identitetin e klientit të madh apo për shumën e të ardhurave që raporton çdo segment nga ai klient. Për qëllime të këtij SNRF-je, një grup njësish ekonomike të cilat njihen nga njësia raportuese se janë nën kontroll të përbashkët do të konsiderohen si një klient i vetëm. Megjithatë, kërkohet gjykim për të vlerësuar nëse një qeveri (qendrore, shtetërore, rajonale, territoriale, vendore ose e huaj) dhe njësitë ekonomike të njohura nga njësia ekonomike që janë nën kontrollin e kësaj qeverie do të konsiderohen si një klient i vetëm. Në vlerësimin e kësaj, njësia ekonomike raportuese do të marrë parasysh shkallën e integrimit ekonomik mes këtyre njësive ekonomike.

Periudha kalimtare dhe data e hyrjes në fuqi

35 Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë SNRF në pasqyrat financiare vjetore për periudhat që fillojnë më datën 1 janar 2009 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Në qoftë se një njësi ekonomike e zbaton këtë SNRF në pasqyrat e saj financiare për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2009, ajo do të japë informacione për këtë fakt.

35A Paragrafi 23 është ndryshuar nga *Përmirësimet në SNRF- të*, të publikuara në prill 2009. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2010 e në vijim. Lejohet zbatimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

36 Informacioni për segmentin për periudhën e mëparshme që është raportuar si një informacion krahasues për çeljen e vitit të zbatimit (përfshirë zbatimin e ndryshimit në paragrafin 23 të bërë në prill 2009) do të ri paraqitet në përputhje me kërkesat e këtij SNRF, përveçse kur informacioni i nevojshëm nuk është i disponueshëm dhe kostoja për ta përgatitur atë do të ishte e madhe.

36A SNK 1 (rishikuar në 2007) ndryshoi terminologjinë e përdorur në të gjithë SNRF-të. Përveç kësaj, ajo ndryshoi paragrafin 23(f). Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore nga 1 janar 2009 e në vazhdim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 1 (rishikuar në 2007) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.[3]

---

2 Për aktivet e klasifikuara sipas paraqitjes së likuiditetit, aktivet afatgjata janë aktive të cilat përfshijnë vlerat e pritura të rikuperohen për më shumë se 12 muaj pas periudhës së raportimit financiar.

3 Në prill 2024, BSNK publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* dhe mbarti këto kërkesa të SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* tek SNRF 18.

36B SNK 24 *Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura* (ndryshuar në vitin 2009) ndryshoi paragrafin 34 për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2011 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 24 (ndryshuar në vitin 2009) për një periudhë më të hershme, ajo do të zbatojë ndryshimin në paragrafin 34 për këtë periudhë më të hershme.

36C *Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2010-2012,* të publikuara në dhjetor 2013*,* ndryshuan paragrafët 22 dhe 28. Një njësi ekonomike do të aplikojë këto amendamente për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2014 ose më pas. Lejohet zbatimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

36D SNRF 18, i publikuar në prill 2024, ndryshoi paragrafin 23. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 18.

Tërheqja e SNK 14

37 Ky SNRF zëvendëson SNK 14 *Raportimi segmentar*.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Shtojcë A
Termi i përkufizuar

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF-së

segment i shfrytëzimit Segmenti i shfrytëzimit është një pjesë përbërëse e një njësie ekonomike:

(a) që angazhohet në veprimtari biznesi nga e cila ai mund të fitojë të ardhura dhe të bëjë shpenzime (përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet të cilat kanë lidhje me transaksionet e kryera me përbërës të tjerë të së njëjtës njësi ekonomike),

(b) rezultatet e shfrytëzimit të të cilit janë shqyrtuar rregullisht nga shefi i marrjes së vendimeve në nivel operativ i njësisë ekonomike për qëllime të marrjes së vendime në lidhje me burimet që do t'i shpërndahen segmentit dhe për të vlerësuar performancën e tij, dhe

(c) për të cilin ka informacion financiar të veçantë.

 © Fondacioni i SNRF-ve